



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ARSIM

Në mbështetje të nenit 8 Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.670/01-62255 të datës 20.12.2024 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2024/2025, Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit, bën këtë:

**NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT
PËR APLIKIM BURSË KOMUNALE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK
2024/2025**

Njoftohen të gjithë studentët e Komunës së Lipjanit se është vazhduar afati për aplikim për bursë komunale sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Konkursin për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit Nr.4-670/01-62802 të datës 24.12.2024 për shkak se gjatë periodës 15 ditore të aplikimit kanë qenë të përfshira 4 (katër) ditë festa zyrtare.

Përmbajtja e konkursit mbetet e njëjtë me konkursin e shpallur në datën e lartëshenuar. Konkursi mbetet i hapur katër (4) ditë pune nga dita e publikimit, përkatësisht deri me datën 14 janar 2025.

Nr. 4-670/01-62802/2

Më datë: 08.01.2025

Drejtori i DKA-së
Rasim Hasani

